



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 10.07.2020, Nr. 09-111/01-25108



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, benë këtë:

R I S H P A L L J E T E K O N K U R S I T

1. SHFMU „Abedin Bujupi ” në Arllat.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 17 orë (8 orë në SHFMU „Abedin Bujupi ”- Arllat, 5 orë në SHFMU „Jusuf Gërvalla”-Negroc, 4 orë në “M.S.Bytyqi”-Bytyq), me kohë të pacaktuar.

2. SHFMU „Shotë Galica ” në Abri e Epërme.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Shotë Galica ” në Abri e Epërme , 5 orë në SHFMU „Migjeni”-Baicë, 4 orë në SHFMU “Gani Elshani”-Kroikovë, 3 orë në SHFMU “Naim Frashëri”-Gllobar), me kohë të pacaktuar.

3. SHFMU „Rasim Kiçina ” në Drenas.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 19 orë, me kohë të pacaktuar.

4. SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 19 orë (8 orë në SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik, 7 orë në SHFMU „Halil Bajraktari”-Drenas II, dhe 4 orë në SHFMU “ Fazli Grejçevci”-Vasilevë), me kohë të pacaktuar.

5. SHFMU „ Ali Gashi ” në Çikatovë e Re.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Ali Gashi ” në Çikatovë e Re , 4 orë në SHFMU „Azem Bejta”-Shtuticë, 4 orë në SHFMU “Dëshmoret e Fortesës”-Verboc, dhe 4 orë në SHFMU “Shaban Polluzha” - Polluzhë), me kohë të pacaktuar.

6. SHFMU „ 7 Marsi ” në Kishnarekë.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 18 orë (7 orë në SHFMU “ 7 Marsi ” në Kishnarekë , 6 orë në SHFMU „Bajram Curri”-Nekoc, dhe 4 orë në SHFMU “Zenel Hajdini”-Tërstenik), me kohë të pacaktuar.

7. SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 19 orë (8 orë në SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran , 7 orë në SHFMU „Luigj Gurakuqi”-Sankoc, dhe 4 orë në SHFMU “24 Korriku”-Fushticë e Poshtme), me kohë të pacaktuar.

8. SHFMU „ Arif Shala ” në Korroticë e Poshtme.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 15 orë (6 orë në SHFMU “Arif Shala”-Korroticë e Poshtme, 5 orë në SHFMU „Shaban Polluzha”-Korroticë e Epërme, dhe 4 orë në SHFMU “Dëshmoret e Qëndresës II” - Tërstenik), me kohë të pacaktuar.

9. SHMP” Fehmi Lladrovci”- Drenas

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë, me kohë të pacaktuar.

10. SHML”GJ.K.Skënderbeu”-Drenas.

- Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, deri sa të kthehet mësimdhënësi prej funksionit zyrtar.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.10 / 2018.

P.S: Në mungesë të kandidatëve me kualifikim përkatës sipas U.A.10 / 2018, do të shqyrtohen aplikacionet me kualifikim më të përafërt.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
5. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
6. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim.
7. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
8. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,

Më:10.07.2020



Drejtoria për Arsim

Muhamet Gjoka